

Jarosław Kaczyński
Kryetar

Partia për Ligj dhe Drejtësi (PiS)

Varshavë, më 5 korrik 2018

I nderuar Zoti Kryetar,
Të nderuar Zotërinj,

Ndjehem jashtë mase i nderuar që salla përfaqësuese në godinën e Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë merr emrin e Presidentit të Republikës së Polonisë Lech Kaczyński si dhe që Vëllai im i Ndjerë do të kujtohet me një pllakë përkujtimore. Ky është një gjest i bukur nga ana Juaj ndaj do të doja të falënderoja nga thellësia e zemrës autoritetet e Kontrollit të Lartë në Shqipëri me Zotin Kryetar Bujar Leskaj në krye.

Jam thellësisht i bindur që bashkëpunimin ndërmjet Institucionit Suprem të Auditit polak me Kontrollin e Lartë të Shqipërisë Presidenti Lech Kaczyński do ta kishte përshëndetur me gëzimin më të madh. Vëllai im i Ndjerë i ka kushtuar rëndësi të madhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimit të përvojës që rrjedh prej tij. Ai konsideronte që përvoja e NIK-ut polak mund të ishte posaçërisht e vlefshme për shtetet e tjera të ish bllokut komunist. Në krye të NIK-ut, në fillimin e vitit 1992, i vuri vetes si objektiv strategjik- sikundër e thoshte vetë- “ndërtimin e një organi kontrolli modern, përshtatur kushteve të demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Ndërtimin e organit, i cili para së gjithash do të ishte i aftë të monitoronte proceset më të rëndësishme në shtet dhe ekonomi, e në mënyrë të veçantë ato procese që lidheshin me transformimet e sistemit. Kusht për realizimin e këtij objekti ishte shkëputja e plotë e NIK-ut nga pushteti ekzekutiv si dhe ndërprerja e të gjitha lidhjeve të mundshme të NIK-ut me subjektet e audituara prej tij.” Ai bëri të

mundur që auditimet e ndërmarra të mos ishin të rastit, por të kishin karakter sistemor, të tillë që përcillte informacion dhe dije për patologjitë në Poloni.

Kurorëzim i punës së Vëllait tim të Ndjerë në funksionin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë ishte përgatitja e ligjit krejtësisht të ri mbi Kontrollin e Shtetit, i cili merrte në konsideratë objektivat e sipërpërmendura si dhe transformimet socialo-politiko-ekonomike. Lech Kaczyński e shkroi atë ligj me vetëdije të plotë se në qoftë se do të miratohej ai vetë do të humbiste funksionin e kryetarit. Të mirën e institucionit, të mirën e kontrollit shtetëror e vuri kësisoj mbi interesat vetjake. Kjo qasje e ka karakterizuar Atë në gjithë veprimtarinë e tij.

Si masë e suksesit të Tij në vendosjen e NIK-ut në binarë të rinj mund të konsiderohet fakti që deri në momentin e marrjes së detyrës besueshmëria e Kontrollit të Lartë në sytë e opinionit publik ishte shumë e ulët, ndërsa në kohën e largimit, institucioni që ai drejtoi gëzonte një vlerësim shumë të lartë dhe besueshmëri tek qytetarët

Këtu do të doja të shtoja se fakti i bashkëpunimit midis Institucionit Suprem të Auditit me Kontrollin e Lartë të Shqipërisë më gëzon shumë jo vetëm si vëlla i Presidentit të Ndjerë Lech Kaczyński, por edhe personalisht. Shpresoj se ky bashkëpunim do të sjellë forcimin e marrëdhënieve midis Popujve tanë, çka do të doja t'ua dëshiroj Zotërinjëve, neve të gjithëve, Shqipërisë dhe Polonisë. Ndërsa Zotit Kryetar Bujar Leskaj i uroj suksese të mëtejshme në drejtimin e Kontrollit të Lartë në Shqipëri.

*Me respekt,
Jarosław Kaczyński*

(Korrespondenca e Kaçinjskit me Kviatkovskin)

I nderuar Zoti Kryetar,

Të falënderoj me gjithë zemër për kujtimin dashamirë dhe ftesën për Tiranë në ceremoninë e dhënies së emrit të Presidentit të Republikës së Polonisë Leh Kaçinjski aulës përfaqësuese në godinën e KLSH së Shqipërisë si dhe zbulimit të pllakës që përkujton Vëllanë tim të Ndjerë. Për fat të keq, për arsye që nuk varen nga unë, nuk do të mund të vij në Tiranë, me dëshirën më të madhe megjithatë do t'u drejtoj një letër pjesëmarrësve të ceremonisë së rastit.

I Nderuar Zoti Kryetar,

Gëzohem shumë që NIK-u merr pjesë në sipërmarrjet ndërkombëtare që kanë për qëllim ndërtimin apo përsosjen e sistemeve të kontrollit shtetëror në zonën e Tre Deteve, Kaukazit Jugor dhe Ballkanit Perëndimor. Ne e dimë mjaft mirë sa e rëndësishme është çështja e institucioneve efektive të kontrollit për zhvillimin e duhur që i shërben së mirës së përgjithshme në vendet e ish bllokut komunist. Vëllai im i Ndjerë me siguri që do ta kishte mbështetur një qasje të tillë.

Edhe një herë, duke Ju falënderuar për kujtimin dhe ftesën, do të doja t'Ju uroja, Zoti Kryetar, Juve personalisht dhe të Afërmve Tuaj, gjithë të mirat.

*Me respekt,
Jarosław Kaçinjski*